



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 016-21692/22

Klinë, datë 26.06.2022

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun me lokalitetet: Zllakuqan, Radulloc, Pataqan, Krushevë e Madhe, Ranoc dhe Leskoc, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "Atë Shtjefën Gjeqovi", në fshatin Zllakuqan. Tubimi u mbajt me datë 21 qershor 2022 dhe filloi në orën 17:00, ku morën pjesë: 8 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e paraqiti ushtruesi i detyrës së drejtorit të drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, z. Ajet Sejdiu, i cili paraqiti buxhetin për vitin 2023 dhe projektet e planifikuara.

Lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore, foli në disa detaje edhe nënkryetarja e komunës së Klinës, znj. Marqe Tanushi Selmanaj, si dhe potencoi projektin afër 300 mijë euro që pritet të realizohet në fshatrat e lartëcekura.

DISKUTIMET

1. Vilson Zefi, parashtrori pyetje për rrugën në Leskoc që janë të papërfunduara si dhe ndërtimi i ujerave të zeza, duke kërkuar njëherësh edhe realizimin total të tyre.

2. Simon Perlaska, paraqiti pakënaqësi për mungesë të ndërtimit të kanalizimit në Pataqan dhe në Zllakuqan, si dhe për mungesën e ujit të pijes në Zllakuqan. Kërkoj që këto projektet të jenë prioritet për realizim.
3. Filip Bibaj nga fshati Ranoc, kërkoj zgjerimin e rrugës “Binak Dodaj”.
4. Mhill Qetaj nga fshati Leskoc, kërkoj shtrimin e rrugës nga Leskoci deri te “Caritas”, që është e gjatë rreth 400 metra, poashtu rregullimin e qeshtjes së ujit të pijes si dhe rregullimin e rrjetit elektrik në fshat.

Takimi përfundoi në ora 18:00.

Procesmbajtësi



The image shows a handwritten signature in blue ink over a horizontal line. To the right of the signature is a circular official stamp in blue ink. The stamp contains the text "REPUBLIKA E KOSOVES" at the top and "KOMUNA E KLINE" at the bottom. In the center of the stamp is a map of Kosovo. The stamp is partially obscured by the signature.